

Aktiviteti reklamues dhe promovues ne TV per vitin 2006

(Nga MCMonitoring, email: info@mcmonitoring.org)

Kohëzgjatja e transmetimit të reklamave gjate vitit 2006 ka qene ne perpuhje me Nenin 53 te Ligjit Nr.8410, datë 30.9.1998 Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë. Ne total, koha ne dispozicion te kanaleve televizive per reklama eshte shfrytëzuar ne 59%¹.

KANALET TELEVIZIVE	MINUTA REKLAME / ORE TRANSMETIMI 7:00-24:00	KOHA REKLAME / TOTAL TRANSMETIMI
KLAN	10.0	12.9%
NEWS 24	3.7	5.3%
SHIJAK	3.9	5.1%
TNSH	1.2	1.4%
TOP CHANNEL	6.8	8.8%
TV KOHA	5.3	6.3%
TVSH	0.8	1.0%
VIZION+	5.2	6.7%
TOTAL	4.6	6.1%

Megjithese, krahasimisht me vitin 2005, koha reklamuese e ketyre kanaleve televizive eshte zvogeluar me 10%, vleresohet se te ardhurat jane rritur me rreth 6% si rezultat i aplikimit te tarifave me te larta². Gjate ketij viti vihet re nje zvogelim te trendit rrites te te ardhurave nga reklamat qe per vitet 2003-2005 ishte rreth 25%.


Transmetimi i reklamave kane qene ne perputhje me dispozitat e Ligjit te mesiperm dhe persa i perket kushteve te transmetimit, tipit dhe permbajtjes. Ne disa raste te pakta jane vene re reklama ne gjuhe te huaj te pa shoqeruara nga subtitrimet ne shqip qe vijne si rezultat i objektivave te tyre te marketingut per ti shoqeruar produktet me slligane ne anglisht.

Duke analizuar reklamat e transmetuara sipas kategorise se produkteve, reth 40 % te shpenzimeve totale per reklame ne televizion gjate

¹ Per kete studim jane trajtuar te dhena nga monitorimi i 8 kanaleve televizive kryesore persa i perket aktivitetit ne fushen e reklamave te vitit 2006. Te dhenat e monitorimit jane marre nga MCMonitoring, kompani qe kryen monitorimin e medias ne Shqiperi qe nga viti 1999. Kanalet televizive te monitoruara jane Klan TV, News 24, Koha TV, TNSH, Top Channel, TVSH dhe Vizion + te cilet transmetojne ne sinjal analog tokesor. Monitorimi perfshin te gjithë transmetimet televizive me objekt reklamues dhe promovues gjate vitit 2006 duke perfshire spotet, shfaqjet e logove, lajmerimet e sponsorizimeve etj. Koha e monitorimit perfshin intervalin kohor 07:00 – 24:00.

² Gjate vitit 2006 MCMonitoring ka regjistruar gjithsej 534,421 evente reklamash. Llogaritja e shpenzimeve eshte bere krahasimisht me vitin 2005 duke konsideruar cmimet zyrtare te kanaleve televizive.


vitit 2006 jane transmetime reklamash ne fushen e telekomunikacionit, pijeve dhe produkteve te perdorimit shtepiak³.



³ Ne grafiket e aktivitetit te reklamave vlerat tregojne vleren e kohes se transmetionit e shprehur ne perqindje te kohes se pergjithshme te transmetimit te reklamave gjate vitit 2006.


Gjate vitit 2006 eshte vene re nje zvogelim i buxheteve per reklama ne kategorite e ushqimeve dhe pijeve me rreth 9%, ndersa ka nje rritje te konsiderueshme ne shpenzimet ne fushen e telefonise celulare dhe bankare me 24% dhe 50% respektivisht.

Koha e transmetimit ne kategorine e reklamave te institucioneve dhe shoqerise publike ka nje ulje me 36% ne krahasim me ate te shfrytezuar per vitin 2005.



Kryesisht ky ndryshim eshte i varur nga konsumi i madh i kohes nga partite politike gjate zgjedhjeve te vitit 2005. Ne kete kategori koha e perdorur per promovimin e aktiviteteve te institucioneve nderkombetare dhe pushtetit vendor perben 70% te saj ose rreth 2287 minuta transmetim. Pushteti qendror,

Institucionet e pavarura dhe organizata jo fitimpruresse me peshe te barabarte kane realizuar 805 minuta transmetim.



Megjithese reklamimi i prodhimeve te vendit 'made in Albania' eshte rritur rreth 4.6 % ne krahasim me ate te vitit 2005, ky eshte ne vlere shume te ulet dhe perben vetem 7.5% te produkteve ne teresi.

Reklamat e prodhuara ne shqiperi jane rritur si ne aspektin sasior ashtu dhe ne ate cilesor. Ne kohe transmetimi ato perbejne rreth 26% te te gjithë hohes se transmetimit te

reklamave.

Ne tregun e reklamave gjate vitit 2006, si pasoje e ligjit Nr.9454, 21.12.2005 i cili perjashton operatorët mediatike nga tatimi per vleren e shtuar mbi

reklamen, vihet re nje zvogelim i blerjes se kohes nepermjet agjensive te reklamave. Kjo tendence ka gjasa te thellohet me tej ne vitin 2007.

MCMonitoring

QNK Bul 'Deshmoret e Kombit', Tirane

info@mcmonitoring.org

Tel +355 42 50770